



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

Anr. 375/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet Blerim Grainca i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Muhamet Xhema – komisioner në vendvotim, në Ferizaj për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 19.06.2014, mori këtë:

**V E N D I M**

**HUDHET** si e palejuar ankesa e parashtruar nga Kandidati për deputet Blerim Grainca nga subjekti politik LDK, dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 18.06.2014, nga Blerim Grainca kandidat për deputet të subjektit politik LDK, dega në Ferizaj, në të cilën pretendohet se komisionari i vv 2532D/01R, Muhamet Xhema, gjatë plotësimit të formularit gabimisht 68 votat ja ka shënuar një kandidati tjetër me numër 75. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur deklaratën komisionarit të këtij vendvotimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati përfundimtar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hedh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu

*PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 375/2014 më datën 19.06.2014

**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**



**Këshillë juridike:** *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjyka Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*